



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

MASAT MBËSHTETËSE NË KUADËR TË **COVID-19**

BALLKANI PERËNDIMOR DHE KROACIA



TETOR 2021


MASAT MBËSHTETËSE NË KUADËR TË **COVID-19**

BALLKANI PERËNDIMOR DHE KROACIA

TETOR 2021

PËRMBAJTJA

- 04 KONTEKSTI
- 06 SHTYLLAT KRYESORE TË MASAVE
MBËSHTETËSE PËR EKONOMITË
- 08 SHQIPËRIA
- 12 KOSOVA
- 15 MAQEDONIA E VERIUT
- 18 SERBIA
- 22 BOSNJA DHE HERCEGOVINA
- 24 MALI I ZI
- 29 KROACIA



KONTEKSTI

Në përpjekje për të kufizuar impaktin ekonomik tek bizneset dhe atë social nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, shumë qeveri duke filluar nga muaji prill 2020 ndërmorën një sërë masash mbështetëse direkte apo indirekte, kryesisht në formën e paketave të integruara të ndihmës.

Dinamika e akteve ligjore dhe nënligjore me të cilat janë marrë këto masa ka qenë shumë e madhe, në varësi edhe të karakteristikave të vendeve të ndryshme, masës së ndikimit në ekonominë përkatëse që pati situata e krijuar, kapaciteteve buxhetore dhe strategjive të ndërtuara nga qeveritë për të përballuar krizën.

Paralelisht me përmbledhjet periodike javore të ligjeve dhe akteve të tjera të përgatitura dhe të dërguara të gjithë partnerëve tanë, përfshirë biznese dhe institucione, Sekretariati përgatiti edhe një përmbledhje të plotë sipas shtyllave kryesore të ndërhyrjes për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroacisë.

Kjo përmbledhje përmban dhe strukturon informacion publik të marrë nga publikimet e FMN, BERZH, OECD dhe burime të tjera të respektueshme, si edhe në referim të kuadrit ligjor të vendeve përkatëse. Ndërhyrjet kanë qenë dinamike dhe në varësi të situatave të krijuara, prandaj edhe përditësimi i informacionit të përfshirë në këtë përmbledhje ka qenë dinamik.

Duke qenë se tashmë prej muajsh ekonominë janë hapur dhe masat drastike duket se janë kufizuar në minimum, ndërsa ekonominë po rimëkëmben, Sekretariati po sjell një publikim të konsoliduar me informacion të përditësuar deri më 14 tetor 2021.

Ky publikim nuk ka objektiv vlerësimin cilësor apo sasior të masave mbështetëse, por të përcjellë informacion koherent për të gjithë të interesuarit si edhe të krijojë një bazë analize të mëtejshme mbi efikasitetin e masave që ndërmerren për të mbështetur ekonominë në kohë krizash të tilla.



SHTYLLAT KRYESORE të masave mbështetëse për ekonominë

Në një vështrim krahasues me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe Kroacinë rezultojnë se shtyllat kryesore të masave mbështetëse nga ana e qeverive janë: (1) masat dhe ndërhyrjet fiskale; (2) mbrojtja e punësimit; (3) masat mbështetëse financiare/monetare dhe (4) masat sektoriale.

NDËRHYRJET FISKALE - pothuajse të gjitha qeveritë kanë qenë aktive duke siguruar masa që mbështesin drejtpërdrejt sipërmarrjet përmes shtyrjes së afatit të pagimit të taksave dhe tatimeve (shtyrja e taksave, kontributet e kujdesit shoqëror/shëndetësor, parapagimet e tatim-fitimit, etj.) Këto janë masa të pastra fiskale që janë marrë nga pothuajse të gjitha vendet e BP sipas specifikave të ndryshme. Në kontekstin e Shqipërisë nënvizohet mbështetja për biznesin e vogël. Nga 1 janari 2021, bizneset e vogla me qarkullim deri në 14 milionë lekë nuk janë subjekte të tatim fitimit, ndërsa pragu për qëllimet e TVSH -së është 10 milionë lekë.

MBROJTJA E PUNËSIMIT - shtylla e dytë e masave është orientuar në subvencionet për paga që kanë për qëllim ruajtjen e vendeve të punës. Mekanizmat e përdorur janë ndihmë direkte për kategoritë e punonjësve, subvencionimi i kontributeve për sipërmarrjet, rritja e pagave në sektorin e shëndetësisë, etj. Fokusi kryesor në masat sipas shtyllës (1) dhe (2) janë bizneset e vogla dhe të vetëpunësuarit.

MASAT FINANCIARE/MONETARE - masat në këtë shtyllë mund të grupohen në 2 kategori: (1) garantimi i likuiditetit (nëpërmjet Garancive Shtetërore) dhe (2) masat për lehtë-

simin e barrës së kredive aktuale të biznesit (nëpërmjet lehtësimit të procedurave dhe shtyrjes së pagesës së kësteve).

MASAT SEKTORIALE - Kroacia duket se ka mbështetur një qasje sektoriale përmes një grupi masash për bujqësinë. Kjo është e lidhur me skemat/fondet e BE-së në dispozicion vetëm të vendeve të BE-së¹. Ndërkohë, qeveria në Kroaci u orientua në blerjen e stokeve të mallrave të gatshme në bujqësi dhe industrinë e agropërpunimit. Mbështetje për bujqësinë ka ofruar edhe Maqedonia e Veriut e cila i ka dedikuar paketën e tretë të masave anti COVID-19 suportit të bujqësisë, përmes mobilizimit të 76,1 milion EUR².

SHËNIM:

Informacioni i përfshirë në këtë publikim nuk është shterues dhe nuk zëvendëson asistencën apo këshillimin profesional që mund t'ju duhet ju apo institucioneve përkatëse. Publikimi përmban informacion të përditësuar deri më 14 tetor 2021.

¹ Komisioni Evropian miratoi një skemë (afërsisht 4 milion €) për të mbështetur sektorin e peshkimit dhe akuakulturës në Kroaci. Skema u aprovua në kuadrin e Kuadrit të Përkohshëm të Ndihmës Shtetërore të miratuar nga Komisioni më 19 Mars 2020, i ndryshuar më 3 Prill 2020.

² Këtu përfshihen a) mbështetje për sipërmarrjet mikro dhe SME-të; b) suport direkt fermerëve të vajit jeshil ku përfshihen rreth 50.000 fermerë me një vlerë prej EUR 4,6 milion; c) Mbështetje për punësues të rrushit dhe vreshtave me një vlerë prej EUR 3,5 milion për një periudhë tre-vjeçare për të stimuluar prodhimin e dizinfektantëve alkolicë; d) kreditim afatgjatë për kullotat në mbështetje të blegtorëve; e) Program financimi për kompanitë mikro-bujqësore me vlerë EUR 3 milion për pajisje përpunimi dhe marketim.



SHQIPËRIA

MASAT FISKALE

Qeveria ka miratuar dy paketa mbështetëse për njerëzit dhe bizneset e prekura nga pandemia Covid-19 me një shumë prej 45 miliardë lekësh (2.8 përqind e PBB-së) që konsistojnë në shpenzime buxhetore, garanci sovrane dhe shtyrje të pagimit të detyrimeve tatimore për kategori të caktuara tatimpaguesish.

PAKETA 1: masa mbështetëse prej 23 miliard lekë (1.4% e PBB) përmes një kombinimi të rialokimeve të shpenzimeve, rritjeve të shpenzimeve dhe garancive sovrane për të mbështetur bizneset e prekura.

1. fonde shtesë për sektorin e shëndetësisë në një shumë prej 3.5 miliardë lekë;
2. 6.5 miliardë lekë për mbështetjen e bizneseve të vogla/të vetëpunësuar që u detyruan të mbyllnin aktivitetet për shkak të pandemisë Covid-19, që konsiston në pagimin e pagave minimale (deri në dy për rastin e bizneseve familjare me familjarë të papaguar); dyfishimi i pagesës së papunësisë dhe ndihmës sociale;
3. 2 miliardë lekë të shpenzimeve të mbrojtjes u rialokuan në ndihmë humanitare për më të prekurit;
4. 11 miliardë lekë (0.6% e PBB-së) fond për garanci sovrane për kompanitë që të përdorin “overdraftin” e tyre në sistemin bankar për të paguar pagat për punonjësit e tyre deri në 3 muaj me një normë interesi në 2.85 përqind për një maturim deri në 2 vjet;
5. Që nga muaji prill, ministrat e kabinetit dhe ligjvënësit do të marrin gjysmën e pagave të tyre për tre muajt e ardhshëm, këto kursime shkojnë në fondin e mbështetjes sociale Anti-Covid 19.

PAKETA 2:

1. Fondi prej 7 miliardë lekë (0.4% e PBB-së) për një ndihmë financiare prej 40,000 lekë për punonjësit e bizneseve të vogla të prekura nga pandemia që nuk përfshihen në paketën e parë, punonjësit e bizneseve të mëdha që u shkëputën nga puna për shkak të pandeminë, dhe punonjësit në sektorin e turizmit;
2. masat e shtyrjes së taksave që lejojnë të gjitha kompanitë (përveç bankave, telekomunikacionit, ndërmarrjeve publike dhe kompanive në zinxhirin e furnizimit të mallrave thelbësorë) të shtyjnë pagesën e tatimit mbi fitimin pas shtatorit.

Turizmi, përpunimi aktiv dhe call-centers - si dhe bizneset e vogla me qarkullim deri në 14 milion - nuk do të paguajnë këstet e parapagimit të tatimit mbi fitimit për vitin 2020;

3. një garanci shtetërore prej 15 miliardë lekësh (0.9 përqind e PBB-së) për të siguruar kredi për kapital qarkullues dhe investime për të gjithë sektorët. Ky është një instrument që ndan rrezikun me bankat, qeveria mbulon 60% të principalit të çdo kredie dhe parashikon kushte shlyerjeje deri në 5 vjet. Parashikohet gjithashtu, periudhë pa shlyerje të principalit (grace period) prej 6 muajsh.

Që nga Janari 2021, bizneset e vogla me qarkullim deri në 14 milionë lekë nuk janë subjekte të tatim fitimit, ndërsa pragu për qëllimet e TVSH -së është 10 milionë lekë.

MONETARE

A. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi:

- (1) pezullimin e shpërndarjes së dividendit nga bankat deri në fund të muajit qershor 2020 për:
 - (a) fitimin e akumuluar të mbartur nga periudhat e mëparshme;
 - (b) fitimet e realizuara në vitin 2019 dhe
 - (c) fitimi që do të realizohet gjatë gjysmës së parë të vitit 2020;

Më 13 janar 2021, banka qendrore hoqi pezullimin e shpërndarjes së dividendëve 2019, por vendosi një pezullim në shpërndarjen e dividendëve të 2020 dhe 2021 deri në fund të 2021.

- (2) duke filluar nga 10 prill 2020, heqja e komisioneve për transferime në monedhën vendase, si dhe për tarifën për pjesëmarrësit në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH të operuara nga Banka e Shqipërisë. Kjo masë kërkon përdorimin e shërbimeve e-banking dhe synon të reduktojë umrin e njerëzve që kërkojnë shërbime në ambientet e bankës.

- B. Banka e Shqipërisë dhe Qeveria e Shqipërisë vendosën që bankat e nivelit të dytë të shtynë për një periudhë 3 mujore pagimin e kësteve të kredisë nga sektori privat në fazën e parë dhe 3 muaj në fazën e dytë, pra gjithsej deri më 31.08.2020.

TË TJERA

1. Duke filluar nga prilli, ministrat e kabinetit dhe ligjvënësit do të marrin gjysmën e pagave të tyre për tre muajt e ardhshëm, këto kursime shkojnë në fondin e mbështetjes sociale Anti-Covid 19. Vendime të tilla janë miratuar edhe nga institucione të tjera si Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, AMF etj.
2. Pezullimi i katër kontratave të PPP-së dhe procedurave të prokurimit publik;
3. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë përgjysmoi pagat e bordit mbikëqyrës të tij dhe menaxhimit të nivelit të lartë në Bankën e Shqipërisë për kohëzgjatjen e pandemisë;

Në shtator 2020, qeveria nisi një Program për Promovimin e Punësimit¹.

Ai synon të mbulojë një pjesë të kostove të papunësisë të atyre që humbën punën gjatë bllokimit. Për punonjësit e sektorit formal qeveria do të mbulojë gjysmën e pagave (në nivelin minimal ligjor) dhe pjesën e plotë të punëdhënësve në kontributet sociale për kohëzgjatjen e programit (4 ose 8 muaj). Punonjësit e sektorit joformal që humbën punën gjatë bllokimit, do të mbulojnë koston e plotë të kontributeve sociale (pjesa e punonjësve dhe punëdhënësve) për 12 muaj nëse formalizohen. Buxheti i vitit 2021 siguroi më shumë fonde për blerjen e vaksinave dhe mbështetjen e rritjes së pagave për stafin mjekësor.



KOSOVA

MASAT FISKALE

Masat tatimore të fokusuar në:

1. alokimin prej 6 milion € për ministrinë e shëndetësisë;
2. shtyrjet e pagimit të detyrimeve për të ardhurat e korporatave, tatimin mbi të ardhurat personale, dhe TVSH-në;
3. parapagimin e pagesave për skemat e ndihmës sociale me një shumë shtesë për një muaj (nga një muaj në dy muaj) për të mbështetur familjet në nevojë;
4. heqja e TVSH-së në importet e grurit dhe miellit;
5. shtyrja e pagesave të faturave të shërbimeve publike deri në fund të prillit. Në vijim, paketa fiskale me një vlerë prej 170 milion euro (2.5% e PBB-së) u miratua nga qeveria.
6. Mbulimi i pagave mujore me një shumë prej 170 euro për punonjës për periudhën prill-maj 2020. Shuma totale e kësaj mase është 41 milion euro. Përveç pagave të mbuluara, qeveria do të paguajë edhe kontributet të lidhura me pensionet për periudhën prill-maj 2020, në shumën totale prej 8 milion euro;
7. Subvencionim për qeratë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në masën 50% të qerave mujore, për periudhën prill-maj 2020, në shumën totale prej 12 milion euro.

SEKTORIALE

1. Mbështetja për likuiditetin financiar do të shtrihet në ndërmarrjet e vogla dhe të vetëpunësuarit në shumë prej 10 mijë euro për një periudhë maksimale prej 24 muajsh, në një total prej 15 milion euro.
2. Mbulimi i pagave mujore prej 130 euro do të jepet për dy muajt e parë për çdo punonjës të ri të punësuar gjatë situatës Covid-19 me një kontratë me afat të përcaktuar të paktën një vit. Mbulimi i përgjithshëm arrin në 6 milion euro.
3. Ndihma financiare për eksportuesit pas përfundimit të situatës Covid-19 do të jetë në shumën totale prej 10 milion euro.
4. Mbështetje për grante dhe institucione qeveritare - Një shumë totale prej 20 milion euro është miratuar për të rritur buxhetin për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe bashkitë e prekura nga situata pandemike.

MONETARE

1. Një shumë totale prej 20 milion euro do jepet në formë kredie pa interes të ripagueshme deri më 31 dhjetor 2020, për ndërmarrjet shtetërore të cilat përballen me vështirësi financiare, personat juridikë/ndërmarrje të autorizuar për të ofruar shërbime thelbësore;
2. Banka Qendrore e Kosovës, së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës vendosën të pezullojnë pagesën e kësteve të kredisë për bizneset dhe individët duke filluar nga 16 marsi deri më 30 prill. Ky pezullim mund të zgjatet në varësi të situatës. BQK-ja do të zbatojë kontrollin rregullator mbi provizionet e kredisë dhe kërkesat e kapitalit për kreditë e riprogramuara.
3. Në shkurt 2021, BQK-ja e vazhdoi më tej programin e ristrukturimit të huasë deri më 31 mars 2021. Zgjatja lejoi huatë që më parë nuk ishin ristrukturuar për shkak të Covid-19 për të zgjatur maturimin me 9 muaj.

MAQEDONIA E VERIUT



PAKETA 1 - (0.2% e PBB-së) për të ndihmuar në adresimin e problemeve të likuiditetit të sipërmarrjeve dhe mbrojtjen e vendeve të punës, të destinuara për sektorët e prekur si transporti, hotelitë dhe restorantet për tre muaj duke filluar nga prilli. Masat përfshijnë:

1. subvencionim për kontributet e sigurimeve shoqërore për firmat që kanë mbajtur të punësuarit gjatë pandemisë;
2. shtyrja e pagesave të taksave të të ardhurave të korporatave duke pezulluar detyrimet për parapagim bazuar në të ardhurat e vitit të kaluar, dhe
3. ndihmë e drejtpërdrejtë financiare për firmat nga Banka e Zhvillimit, duke ofruar kredi me normë interesi 0.

PAKETA 2 - (rreth 1% e PBB-së).

1. Një subvencion për pagat e barabartë me pagën minimale për kompanitë e prekura për t'i ndihmuar ato që të mbajnë punonjësit në punë.
2. Familjet e riskuara që ishin pjesë e ekonomisë informale dhe humbën të ardhurat e tyre do të marrin ndihmë financiare.
3. Financime shtesë do të vihen në dispozicion nga Banka e Zhvillimit për bankat tregtare me kushte të favorshme.
4. Qeveria ka zbatuar gjithashtu kontrolle çmimesh për produktet kryesore ushqimore, medikamentet dhe produktet e dezinfektimit, dhe ka hequr detyrimin e importit për materialet mjekësore.

PAKETA 3

1. Si pjesë e paketës së tretë të masave, Qeveria po planifikon të shpërndajë kupona pagesash të kredituara me 3.000 denarë dhe 6.000 denarë kuponë për të stimuluar turizmin vendas nga familjet më të varfra. Masa do të prekë rreth 100.000 qytetarë nga familjet më të varfëra, d.m.th. të cilët fitojnë më pak se 15.000 denarë në muaj (paga minimale është 14.500 denarë në muaj). Kuponat do të përdoren në hotelet-shtëpi dhe ambiente të tjera akomodimi, për të inkurajuar blerjen e produkteve dhe shërbimeve të turizmit vendas.
2. Paketa e tretë e masave që mbështesin bujqësinë do të mobilizojnë deri në 76.1 milion EUR. Ajo përfshin mbështetje për ndërmarrjet mikro dhe SME; mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët që kultivojnë kulturat për Green Oil. Masa do të përfshijë 50.000 fermerë dhe është me vlerë 4,6 milion EUR; Mbështetja për përpunuesit e rrushit dhe verërat me 3.5 milion EUR për tre vjet për të stimuluar prodhimin e alkoolit që do të përdoret nga kompanitë kimike vendase për të prodhuar dezinfektues; Qiraja afatgjatë e kullotave për të mbështetur blegtorët

dhe një program për financimin e ndërmarrjeve mikro-bujqësore në vlerë prej 3 milion EUR për pajisjet e përpunimit dhe marketingun.

SEKTORIALE

1. Shtyrje të afateve për pagimin e kësteve;
2. Një total prej 5.5 milion euro do të jepet si hua pa interes për kompanitë që kryejnë aktivitete biznesi në sektorët më të prekur nga Covid-19;

MONETARE

Masat nga Banka Kombëtare:

1. Fillimisht uli normën e saj të politikës me 25 pikë bazë në 1.75%. Banka ka ulur normën e saj të politikës tre herë që nga fillimi i krizës me një 75 pikë bazë kumulative në 1.25%
2. Tarifat për tërheqjen dhe kthimin e parave në kasafortën qendrore të Bankës Kombëtare janë hequr për të minimizuar çdo risk të transmetimit të infeksionit të virusit me anë të monedhave dhe faturave.
3. Rishikimi i rregullores së riskut të kredisë, për të inkurajuar bankat që të rishturojnë përkohësisht huatë duke lehtësuar tandardet e klasifikimit të kredive të këqija (NPL). Gjithashtu ka ulur bazën për kërkesat e rezervës me sasinë e kredive të reja për firmat në sektorët e prekur, dhe ka zgjeruar afatin që bankat të paraqesin Raportin e parë të Vlerësimit të Likuiditetit të Brendshëm në mënyrë që të lejojë përqendrimin në sigurimin e kredisë duke ruajtur cilësinë e portofolit të kredisë.

Në shkurt 2021, Banka vendosi të kufizojë përkohësisht pagesat e dividendëve nga bankat, përveçse në formën e aksioneve, duke forcuar kështu udhëzimet mbikëqyrëse të vitit 2020. Kufizimi aktualisht është në fuqi deri në vitin 2021, por do të rishikohet jo më vonë se Shtator 2021.

TË TJERA

Masat e mbledhjes së detyrueshme të detyrimeve:

1. Autoritetet tatimore njoftuan se nuk do të bëjnë asnjë mbledhje të detyruar në lidhje me të gjitha taksat dhe tarifatat e tjera publike (gjjobat, tarifatat gjyqësore) ndaj tatimpaguesve që nuk kanë paguar detyrimet e tyre.
2. Pezullimi për ligjin e përmbarimit deri në fund të qershorit, duke detyruar agjentët e përmbarimit të ndalojnë ndërmarrjen e çdo veprimi përmbarimi.



SERBIA

MASAT FISKALE

(6.5 përqind e PBB-së) u përqëndruan në:

1. rritje të pagave me 10% për sektorin e shëndetësisë publike (13 miliardë RSD) dhe rritjen e shpenzimeve për shëndetësinë (rreth 26 miliardë RSD);
2. pagesa për të gjithë pensionistët (7 miliardë RSD);
3. një transfertë, prej 100 euro për secilin qytetar mbi 18 vjeç (rreth 65 miliardë RSD);
4. shtyrja tre-mujore e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për të gjitha kompanitë private, për tu paguar me 24 këste duke filluar nga viti 2021 (100 miliardë RSD);
5. shtyrja e pagimit të kësteve për parapagimin e taksave të të ardhurave të korporatës gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 (21 miliardë RSD);
6. subvencione për pagat, përfshirë pagimin e pagave minimale për të gjithë punonjësit e SME-ve dhe sipërmarrësit për tre muaj (93 miliardë RSD) dhe pagesa e 50% të pagës minimale neto për tre muaj për punonjësit në ndërmarrje të mëdha të sektorit privat dhe për të papunësuarit (4 miliardë RSD).
7. moratorium 3-mujor për interesat e borxhit tatimor në bazë të marrëveshjeve të ristrukturimit dhe reduktimin me 10 pikë përqindje të normës së interesit të borxhit tatimor.
8. Një garanci nga shteti është aprovuar për kreditë bankare për NMV-të (240 miliardë RSD), si dhe për kreditë e reja për NMV-të nga Fondi i Zhvillimit (24 miliardë RSD).

Një raund i dytë masash u miratua në fund të korrikut 2020, duke përfshirë subvencionet e pagave për punonjësit e NVM-ve për dy muaj të tjerë (36 miliardë RSD), dhe shtyrjen e taksave të punës dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore për të gjitha kompanitë private për një muaj shtesë (30 miliardë RSD).

Një buxhet shtesë me masa të reja mbështetëse u miratua në Prill 2021. Masat e reja përfshijnë: (i) subvencionet e pagave, duke përfshirë pagesën e ½ të pagave minimale për të gjithë sipërmarrësit dhe punonjësit në NVM -të dhe kompanitë e mëdha për tre muaj (69.8 miliardë RSD); (ii) pagesa shtesë për punonjësit në udhëtime, mikpritje dhe art (4.4 miliardë dollarë); (iii) transferimi pa përjashtim 60 EUR për secilin qytetar mbi 18 vjeç, i paguar në dy këste

prej 30 EUR secila-në maj dhe nëntor (43.2 miliardë RSD); (iv) një pagesë e njëhershme prej 50 EUR për të gjithë pensionistët (10 miliardë dollarë); (v) një ndihmë financiare e njëhershme prej 60 eurosh për të gjithë të papunët, e paguar në qershor (4.3 miliardë dollarë); dhe (vi) mbështetje për sektorin e transportit dhe hotelet e qytetit (3.9 miliardë dollarë). Kostoja totale e vlerësuar arrin në 2.3 përqind të PBB -së.

SEKTORIALE

Në fund të gushtit 2020, autoritetet njoftuan mbështetje fiskale të njëfishtë për të ndihmuar hotelet në qytete, përmes një subvencioni fiks për dhomë dhe shtrat, me një kosto prej rreth 0.02 përqind të PBB-së.

SUBVENCIONE PËR HOTELE

Për shkak të madhësisë së ndikimit të Covid-19 në industrinë e akomodimit, Qeveria ka zbatuar paketën mbështetëse të përbërë nga pothuajse 11 milionë euro subvencione. Pagesa e subvencioneve për 312 hotele që kanë aplikuar është filluar në tetor dhe përbëhet nga 350 euro për shtrat dhe 150 euro për njësi akomodimi.

SUBVENCIONET PËR OPERATORËT TURISTIKË DHE AGJENCITË TURISTIKE

Në Nëntor 2020, Ministria e Turizmit dhe Telekomunikacionit Tregtar ka publikuar thirrjen për paraqitjen e aplikimit për subvencione për operatorët turistikë dhe agjencitë. Agjencitë e pranueshme do të marrin deri në 5.000 EUR, për primet e policës së sigurimit, në varësi të llojit të licencës që ata mbajnë. Shuma totale e alokuar është përafërsisht 1.28 milionë euro.

MONETARE

Masat nga Banka Kombëtare:

1. ulja e normës bazë të politikës nga 2.25% në 1.75% dhe më vonë në 1,50% dhe ngushtimi i intervalit të normës së interesit nga ± 1.25 pikë përqindje në ± 1 pikë përqindje në krahasim me normën kryesore të politikës.
2. sigurimi i likuiditetit për bankat (si në dinarë ashtu edhe në euro) përmes ankandëve shtesë të këmbimit EUR/RSD dhe ankandëve për blerjen e të letrave me vlerë (REPO) të qeverisë;
3. ulja e normave të interesit në këmbimin valutor;

- Moratorium për qiradhënie dhe kredi, përfituesit kanë të drejtë të vonojnë pagesat e detyrimeve që kanë ardhur brenda 3 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e vendimit.
- Ofruesit e qirasë nuk mund të faturojnë interes për borxhet e prapambetura dhe nuk mund të fillojnë procedurën e arkëtimit kundër qiramarrësit, ose të ndërmarrin ndonjë veprim tjetër ligjor për të mbledhur arkëtimet nga qiramarrësi.

TË TJERA

Në tetor 2021, Qeveria e Republikës së Serbisë miratoi dy Dekrete që zgjerojnë metodat për dhënie e stimujve shtetërorë. Dekreti i Parë fokusohet në mundësinë që Qeveria të financojë kompanitë e kualifikueshme përmes blerjes së përkohshme të aksioneve të pronësisë dhe jo pronësisë. Dekreti i Dytë i lejon Qeverisë të financojë një pjesë të shpenzimeve fikse të kompanive të cilat kanë rënë ose pushuar aktivitetet për shkak të Covid-19. Megjithatë, Dekretet nuk përfaqësojnë masa të zbatueshme, vetëm një bazë ligjore për programet e mundshme të Ndhmës Shtetërore të planifikuara. Ende nuk ka asnjë koment zyrtar për aktivitete të tilla.

BOSNJA & HERCEGOVINA

MASAT FISKALE

1. Masat e marra nga Federata e Bosnia dhe Hercegovinës (FBiH) përfshijnë subvencionimin e kontributeve dhe taksave, pagimin e pagave minimale të të gjithë kompanive të prekura nga pandemia Covid-19;
2. Rep. Serbska vendosi të mbulojë PIT dhe SSC për rreth 40,000 punëtorë në sektorët që janë mbyllur me vendim të qeverisë nga marsi deri në maj (50 milion KM, 0.15% e PBB-së). Gjithashtu, njoftoi se qeveria do të paguajë pagat minimale për të gjithë punonjësit në këta sektorë në prill (53 milion KM, 0.16% e PBB-së) dhe po planifikon rritjen e transferimeve në fondet e papunësisë (25 milion KM, 0.08% e PBB-së).

SEKTORIALE

Mbështetje për ekonominë përmes:

1. ngritjes së një fondi të veçantë për të stabilizuar ekonominë (500 milion KM, 1.5% e PBB-së);
2. krijimi i një fondi garancie në Bankën e Zhvillimit (deri në 500 milion KM, 1.5% e PBB-së) i cili do të shërbejë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e likuiditetit të kompanive. Gjithashtu, zhvillimin e një skeme mbështetëse për garantimin e kredisë.

MONETARE

1. Agjencitë bankare kanë njoftuar një moratorium 6 mujor për shlyerjen e kredisë, për të rregulluar ristrukturimin e kredisë për individë dhe persona juridikë, për të cilët është konstatuar se gjenden në rrethana të vështira për shkak të Covid-19.
2. Agjencitë bankare kanë udhëzuar bankat të gjurmojnë klientët dhe portofolet e prekura nga Covid-19. Bankat gjithashtu udhëzohen të marrin në konsideratë lehtësimin konsumator, përfshirë rishikimin e tarifave aktuale për shërbimet dhe shmangien e tarifimit për të përballuar ekspozimin ndaj ndryshimeve;
3. Të gjitha bankave u është dhënë urdhër për të mos paguar dividendë ose shpërblime.



MALI I ZI

PAKETA 1:

1. heqja e akcizës për alkoolin mjekësor të shitur në farmaci;
2. shtyrje e pagesave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore;
3. krijimi i një linje kredie të Fondit të ri të Zhvillimit të Investimeve (IRF) prej 120 milion euro për të përmirësuar likuiditetin e sipërmarrësve;
4. shtyrja e pagesave të qirasë për pronat e paluajtshme shtetërore;
5. paradhënie për kontraktuesit për projektet kapitale;
6. ndihmë financiare për pensionistët me të ardhura të ulëta dhe përfituesit e mirëqenies sociale në shumën prej 50 euro secila kategori (1 milion euro është ndarë);
7. një rritje në pagat e muajit Mars të punonjësve të sektorit shëndetësor deri në 15 përqind (janë ndarë 0.5 milion euro).

PAKETA 2: në shumën prej 75 milion euro (me një ndikim neto prej 40 milion euro) përfshin:

1. subvencione në prill dhe maj me 70% të pagës minimale për punonjësit në sektorë që janë mbyllur për shkak të pandemisë, punonjësit që nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të kujdesit të fëmijëve për fëmijët e moshës nën 11 vjeç, ose njerëzit që duhet të jenë të izoluar dhe të karantinuar;
2. një subvencion prej 50% të pagës minimale për të punësuarit në sektorët me risk për shkak të bllokimit nga pandemia;
3. një subvencion prej 70% të pagës minimale bruto të sapopunësuarve në NMV për gjashtë muaj nëse këta punëtorë janë regjistruar si të papunë;
4. organet shtetërore dhe ndërmarrjet shtetërore do të vendosin një moratorium gjashtëmuajor në zbatimin e kërkesave për kompanitë që nuk funksionojnë për shkak të pandemisë;
5. firmat e energjisë elektrike do të përjashtojnë pagesën fikse nga faturat e energjisë për bizneset që nuk kanë aktivitet për shkak të pandemisë;
6. ndërmarrja shtetërore do të dyfishojë subvencionet e energjisë elektrike për familjet në nevojë;
7. ndihmë për sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, duke përfshirë ndihmën financiare për peshkatarët dhe pagesa për kontributet e punëtorëve të siguruar bujqësorë;

8. ndihmë prej 50 euro për të gjithë personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit të Malit të Zi dhe që nuk kanë marrë asnjë kompensim tjetër.

PAKETA 3: Miratuar nga Qeveria më 23 korrik 2020 përbëhej nga masa afatshkurtra dhe afatgjata me vlerë 1.22 miliardë euro për katër vjet (281.2 milionë euro në 2020). Masat afatshkurtra në këtë paketë përfshijnë:

1. mbështetje për sektorin e turizmit (siç janë subvencionet e interesit për huatë dhe ulja e TVSH-së nga 21 përqind në 7 përqind në industrinë e hotelerisë);
2. subvencione interesi për sektorin e bujqësisë;
3. programe për nxitjen e konkurrencës;
4. subvencionet e pagave;
5. mbështetje e njëhershme për veteranët dhe pensionistët.

PAKETA 4: e shpallur më 28 Janar 2021 prej 163 milionë euro. Masat përfshijnë:

1. subvencione për paga (me një listë të zgjeruar të sektorëve të pranueshëm);
2. mbështetje e njëhershme për popullsinë e cënueshme;
3. shtyrjet e taksave;
4. mbështetje për punësim të ri;
5. mbështetje e njëhershme për firmat për të zbatuar e-fiskalizimin;
6. kuponë udhëtimi të brendshëm për punonjësit e shëndetësisë dhe arsimit;

dhe masa shtesë për sektorët e turizmit, hotelerisë, bujqësisë dhe peshkimit. Masat kanë për qëllim ruajtjen e niveleve të punësimit, përmirësimin e likuiditetit, rritjen e numrit të turistëve, stabilitetin e bujqësisë, si dhe mbështetjen e popullatës në vështirësi.

PAKETA 5: 29 prill 2021, u miratua një paketë e re masash mbështetëse për bizneset dhe qytetarët për tremujorin e dytë, me një vlerë prej 160 milionë eurosh. Kjo paketë përfshin një reduktim të faturave të energjisë elektrike për grupet më në vështirësi dhe një plan të ri të subvencionimit të pagës.

MONETARE

Masat e Bankës Qendrore:

1. moratorium për shlyerjen e kredisë për një periudhë deri në 90 ditë. Përfshirë pezullimin e përkohshëm të të gjitha pagesave të detyrimeve të bazuara në kredi

(principali, kamata, interesi i paracaktuar, tarifat, etj.).

2. Gjithashtu, bankat mund të ristrukturojnë kreditë dhe t'i riklasifikojnë ato si kredi të reja, duke përfshirë duke zgjatur periudhën e ripagimit deri në dy vjet, nëse pozicioni financiar i huamarrësit është ndikuar nga pandemia dhe ristrukturimi do të përmirësonte kapacitetin e kredisë së huamarrësit. Këto masa vlejné gjithashtu edhe për institucionet e leasing dhe të mikrofinancës.
3. Banka qendrore ka njoftuar masa për të ndaluar përkohësisht bankat të paguajnë dividendë ndaj aksionarëve, përveç në formën e kapitalit neto, dhe të lejojnë bankat të rrisin ekspozimet ndaj një personi ose palëve të lidhura përtej kufijve të parashikuar të ekspozimit (25% të fondeve të vetë bankës), me miratimin paraprak të bankës qendrore.
4. Po konsiderohen masa shtesë, përfshirë shtrirjen e moratoriumit tek huamarrësit më të rrezikuar, sigurimin e hyrjes në linjat e kreditit për sistemin financiar përmes BERZH-it dhe Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC), dhe uljen e çmimit të tërheqjes së rezervave të kërkuara për likuiditetin bankar.

Në korrik 2020, BQ vendosi që bankat janë të detyruara të japin një moratorium për huamarrësit nga dy sektorë prioritarë: turizmi, si dhe bujqësia, pylltaria dhe peshkimi. Moratoriumi mund të përdoret në periudhën nga 1 shtator 2020 deri më 31 gusht 2021, dhe është në dispozicion për huamarrësit në këta sektorë të cilët nuk kanë vonesë në shlyerjen e huave për më shumë se 90 ditë dhe kreditë e të cilëve nuk u klasifikuan si me probleme aktivet më 31 dhjetor 2019. Bankave u lejohet gjithashtu të trajtojnë kreditë e miratuara ose të ristrukturuara në këta sektorë si hua nga kategoria "A" gjatë kohëzgjatjes së specifikuar më sipër.

Në tetor, 2020, BQ ndërhyri duke ndihmuar qytetarët më të prekur. Ai prezantoi një moratorium gjashtëmujor për shlyerjen e huave për qytetarët që kanë humbur punën pas 31 marsit për shkak të krizës Covid-19 dhe nuk e kanë vonuar shlyerjen e kredive të tyre me më shumë se 90 ditë para fundit të vitit 2019, dhe të cilëve kreditë nuk janë klasifikuar si me probleme deri në fund të vitit 2019. Masat e tjera përfshijnë një ristrukturim të kredisë për qytetarët, pagat e të cilëve kanë rënë me të paktën 10 përqind për shkak të pandemisë dhe një ndryshim në sasinë e depozitave pa afat të përfshira në llogaritjen e detyrimeve të papaguara (20 përqind në vend të 30 përqind).

Më 28 prill 2021 filloi masat e reja. Ata u përqëndruan në ndërmarrjet mikro, të

vogla dhe të mesme dhe qytetarët. Ai zgjeron listën e sektorëve të pranueshëm për përfituesit e huave që kanë të drejtë në moratorium, miratim dhe ristrukturim të huave me trajtim rregullator preferencial. Përfituesit huanë, të ardhurat e të cilëve janë ulur me më shumë se 10 përqind për shkak të pandemisë, mund të zgjaten një periudhë shlyerje me një maksimum prej pese vite. Bankat gjithashtu mund të bien dakord për një afat më të gjatë kur ristrukturojnë dhe klasifikojnë kreditë për personat fizikë, përfshirë ato kur kredia nuk sigurohet me kolateral. Periudha e zgjatjes mund të jetë deri në pesë vjet, me kusht që afati i maturimit të mos kalojë 10 vjet.

Më 25 maj 2021, Banka Qendrore zgjeroi kategoritë e kompanive që janë përfituese të huasë së moratoriumit (duke përfunduar më 31 gusht 2021) për të përfshirë edhe ato të ardhurat totale të të cilëve në vitin 2020 ishin të paktën 50 përqind më të ulëta se në vitin 2019.

TË TJERA

1. Shtyrja e pagesave të qerasë për pasuritë e paluajtshme ndër një periudhë 90 ditore.
2. Pagesa paraprake për ofruesit e shërbimeve dhe kontraktuesit për projektet kapitale duke filluar me sigurimin e një garancie bankare në vlerën e paradhënies për të siguruar likuiditetin dhe për të ruajtur vazhdimësinë e punës, kur kjo nuk rrezikon shëndetin e qytetarëve.



KROACIA

MASAT FISKALE:

1. (1) shtyrja e detyrimeve publike, pa interes për tre muaj, e cila mund të zgjatet edhe për tre muaj të tjerë nëse është e nevojshme;
2. (2) pezullimi i përkohshëm i pagesave të tarifave parafiskale; hua pa interes për qeveritë lokale, Institutin Kroat të Sigurimeve Shëndetësore dhe Institutin Kroat të Sigurimeve për Pensionet për të mbuluar pagesat e shtyra;
3. (3) subvencionimi i pagave minimale për tre muaj për të ruajtur vendet e punës, të cilat mund të zgjaten edhe për tre muaj të tjerë;
4. (4) rimbursimi i parakohshëm i tatimeve për individët;
5. (5) një rritje e subvencionimit të pagës minimale neto;
6. (6) reduktimin ose fshirjen e detyrimeve tatimore për ndërmarrjet në varësi të xhiros dhe humbjeve të tyre;
7. (7) Pagesat e TVSH-së nuk do të kryhen derisa të merren pagesat nga klientët dhe afati për raportimet financiare të vitit 2019 do të zgjatet deri më 30 qershor.

Në qershor 2020, qeveria njoftoi mundësinë e prezantimit të një programi pune me kohë të shkurtër, të financuar nga EU SURE, për të mbrojtur vendet e punës, kështu që punëdhënësit të cilët kanë nevojë të prezantojnë orë më të shkurtra pune për shkak të rënies së aktiviteteve të biznesit, do të kenë të drejtë në ndihmë për pagesën e një pjesë e pagave të punëtorëve të tyre. Masa ka për qëllim të gjithë sektorët dhe të gjithë bizneset me më shumë se 10 punonjës. Në Shtator 2020, masat e krijuara për të ndihmuar sektorët ekonomikë të goditur nga kriza e koronavirusit, përfshirë ato të krijuara për të mbajtur vende pune dhe për të siguruar likuiditet dhe kredi për Covid-19, u zgjatën deri në fund të vitit. Për të gjithë sektorët, qeveria do të bashkëfinancojë një javë pune më të shkurtër me një maksimum 2,000 HRK për punëtor plus kontribute, si dhe do të ofrojë ndihmë për mikro bizneset deri në fund të dhjetorit, gjithashtu në shumën prej 2,000 HRK për punëtor, nëse punëdhënësi ka pësoi një rënie të qarkullimit prej më shumë se 50 përqind. Për aktivitetet që janë veçanërisht në rrezik (transporti i udhëtarëve, mikpritja, agjencitë e udhëtimit dhe bizneset që lidhen me rekreacionin, si dhe ngjarjet kulturore, të biznesit dhe sportit), ofrohet mbështetje në shumën prej 4,000 HRK për punonjës deri në fund të dhjetorit 2020, nëse rënia e tyre në qarkullim tejkalon 60 përqind. Më 24 Shtator, afati për Ndërmarrjet Shtetërore-të për të paguar fitimin në buxhet u zgjat deri më 15 janar.

Që nga fundi i nëntorit, qeveria financon kostot e sipërmarrësve puna e të cilëve u pezullua me Vendimin e Shtabit të Mbrojtjes Civile. Shpenzimet e përgjithshme rimbursohen për sipërmarrësit me një rënie të të ardhurave prej të paktën 60% në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar ose në krahasim me muajin e mëparshëm të vitit aktual, nëse sipërmarrësi filloi të punonte në vitin 2020. Sipërmarrësit me një rënie të të ardhurave/faturat e 40-60% ose 2,000 - 3,500 KRK, respektivisht, gjithashtu kanë të drejtë të mbështeten brenda skemës së punës.

Në dhjetor 2020 qeveria njoftoi vazhdimin e masës prej 4,000 HRK për punonjës në janar dhe shkurt 2021 për të mbrojtur vendet e punës në bizneset e detyruara të mbyllën si pjesë e përpjekjeve për të frenuar përhapjen e pandemisë koronavirus. Në fund të shkurtit 2021, grantet e mbajtjes së punës u zgjatën me një muaj tjetër. Masat ekzistuese aktive të tregut të punës u zgjeruan, për shembull, programet e trajnimit të aftësive të punës për personat aktualisht të papunë për të punuar në profesione që përjetojnë mungesë të fuqisë punëtore.

SEKTORIALE

1. (1) Përfituesit e investimeve dhe disa fondeve strukturorë të BE-së do të jenë në gjendje të marrin parapagime. Një pjesë e fondeve të BE-së është shpërndarë në mikro kredi, duke prezantuar një linjë të re krediti, e shoqëruar me masa për të lehtësuar disbursimet e shpejta të kredive me norma më të ulëta të interesit, dhe garanci më të mëdha nga riskut të pjesshëm.
2. (2) Qeveria ka ndihmuar në blerjen e stoqeve të pasitura të mallrave të gatshëm në bujqësi, industrinë e përpunimit ushqimor, pajisjeve mjekësore dhe mallrave strategjikë.
3. (3) Financim për pezullimin e përkohshëm të sektorit të peshkimit me miratimin paraprak të Komisionit Evropian.
4. (4) Ndihma për sektorin e bujqësisë për shkak të kufizimeve të lëvizjeve dhe rritjes së kostove të manipulimit.
5. (5) Rritje e fondeve për ndihmë minimale për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.
6. (6) Krijimi i një linje kredie për kapitalin qarkullues për sektorët e bujqësisë, pylltarisë dhe përpunimit të drurit.

7. (7) Ndihma shtetërore: Komisioni i BE miraton skemën e granteve të drejtpërdrejta kroate prej 4 milion € për të mbështetur sektorin e peshkimit dhe akuakulturës për shkak të pandemisë.

Në Janar 2021, Komisioni Evropian (KE) miratoi programin e ndihmës shtetërore të Kroacisë prej 1.53 miliardë HRK për kompanitë në fushën e turizmit dhe sportit, i cili do të zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë kroate të Turizmit dhe Sporteve, Bankën Kroate për Rindërtim dhe Zhvillim (HBOR), Agjencia Kroate për NVM-të, Inovacionet dhe Investimet (HAMAG-BICRO) dhe bankat komerciale. Programi parashikon lëshimin e një garancie shtetërore në masën 100% të principalit të huasë për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe deri në 90% për ndërmarrjet e mëdha. Mbështetjet në vlerë deri në 800.000 euro për sipërmarrës do të jepen më së voni deri më 30 qershor të këtij viti, por vetëm për kompanitë që nuk ishin në vështirësi më 31 dhjetor 2019, me përjashtim të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla të cilat kanë të drejtë edhe nëse ata kishin probleme biznesi në atë datë. Kreditë e reja janë të destinuara për kapital qarkullues dhe investime, si dhe subvencionim të normave të interesit.

MONETARE

Banka Kombëtare siguroi likuiditet përmes:

1. (1) marreveshtjet Repo, i përdorur për herë të parë që nga dhjetori i vitit 2018 (likuiditeti 5-vjeçar prej 3,8 miliardë HRK me një normë fikse të interesit prej 0,25 përqind);
2. (2) Repo të rregullta javore të përdorura nga bankat për herë të parë që nga dhjetori 2017. Kjo normë e repos është reduktuar nga 0,30% në 0,05%; dhe
3. (3) një ulje e normës së kërkesës së rezervës (nga 12% në 9%)

Vendosja e një moratoriumi 3 mujor mbi obligacionet bankare. Bankat nuk mund të zbatojnë masat e mbeldhjes gjatë kësaj periudhe.

Banka Kroate për Rindërtim dhe Zhvillim (HBOR) ka lëshuar një moratorium për shërbimin e borxhit për tre muaj, sigurimin e kredisë për likuiditet, garanci për eksport dhe detyrime të ristrukturimit. Në prill, Komisioni Evropian miratoi programet e subvencionuara të kredisë deri në 1.8 miliardë €.

TË TJERA

Qeveria Kroate prezantoi masa të reja për ruajtjen e vendeve të punës në sektorët e prekur nga Covid-19. Aktualisht janë 3 masa që janë në dispozicion për punëdhënësit.

1. (1) Grant për të mbështetur orarin e reduktuar të punës gjatë qershorit deri në dhjetor 2020;
2. (2) Grant për ruajtjen e vendeve të punës në punëtoritë e strehuara, punëtoritë integruese dhe njësitë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara gjatë korrikut deri në dhjetor 2020;
3. (3) Granti për ruajtjen e vendeve të punës për sektorë të caktuar të prekur nga Covid-19 - gjatë tetorit deri në dhjetor 2020.

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council